



**KUR'ANI NË THËNIET
E PROFETIT DHE TË EHLE BEJTIT**

(Paqja qoftë mbi ta!)

Tiranë, 2025

**Titulli: Kur'ani në thëniet e Profetit dhe
të Ehli Bejtit** (*Paqja qoftë mbi ta!*)

Përktheu nga arabishtja: **Haxhi Shejkh
Vullnet MERJA**

Redaktoi: **Jerida KULLA**

Korrekttoi: **Ma. Isra MERJA**

Përgatiti për shtyp & Kopertina: **Sabrie FEZA**

Botoi: **"Fondacioni i Kur'anit"** - Tiranë, 2025

DOBITË E STUDIMIT TË KUR'ANIT

**Me emrin e Allahut, të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

*Falënderimet i takojnë Allahut të
Madhëruar. Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi
Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër
dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!*

Kur'ani i Shenjtë është baza e fesë dhe
porta hyrëse në Islam. Ai është libri i Allahut,
në të cilin i Plotfuqishmi, i Gjithëdituri dhe i

Urti ka vendosur ligjet dhe të vërtetat e fesë së Tij të fundit e të pastër, Islamit. Allahu e zbriti Kur'anin udhërrëfyes dhe ndriçues për mbarë njerëzit. E zbriti që t'i nxjerrë njerëzit nga errësirat në dritë.

Allahu na urdhëron që të kapemi pas Kur'anit dhe ta zbatojmë atë në jetën tonë të përditshme. Kur'ani është Fjala e Tij e plotë dhe e përkryer. Allahu i Madhëruar thotë:

وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

“Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe druajuni

kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni.”¹

Nuk vjen libër tjetër nga Allahu pas Kur'anit. Ai është këshillë, shërim dhe mëshirë. Është dritë dhe udhëzim. Kushdo që dëshiron të arrijë sa më afër Krijuesit të tij, duhet të ketë Kur'anin prijës në jetën e vet.

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Nëse dëshironi jetësën e të lumturve, vdekjen e dëshmorëve, shpëtimin në Ditën e vështirësisë, hijëzimin në ditën e nxehtë dhe udhëzimin në ditën e humbjes, studiojeni Kur'anin sepse ai është Fjala e Rahmanit (Gjithëmëshirmit),

¹ Sure “En'am”, ajeti 155.

mbrojtje prej djallit dhe anues për nga veprat e mira në peshore.”²

E kanë pyetur Imam Rizain (*Paqja goftë mbi të!*): Çfarë thua për Kur’anin? Ai ka thënë: *“Është fjala e Allahut dhe mos dilni para tij. Mos kërkonj udhëzim prej tjetër kujt përveç tij se do të humbisni.”³*

Kur’ani është përsosmëria e vërtetë. Cilido që e mëson Kur’anin dhe e kristalizon atë në brendinë e tij, sigurisht që ai mbart një mirësi të madhe dhe pasuri të pashtershme. Kur’ani është tryeza e Allahut për njerëzit. Ai e ka zbukuruar këtë tryezë me llojet më të përsosura e të panumërta të ushqimeve për

² “Mustedrekul Uesail”, vëllimi 4, faqe 232.

³ B”iharul Anur”, vëll. 89, f. 117.)

dijen dhe shpirtin. Në këtë tryezë gjendet çdo gjë për të cilën kanë nevojë njerëzit.

Allahu i Madhëruar thotë:

{وَلَقَدْ صَرَبْنَا لِلنَّاسِ فِي هَٰذَا الْقُرْآنِ مِنْ كُلِّ مَثَلٍ لَّعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ}

“Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj në këtë Kur'an për çdo gjë, për t'ua vënë veshin.”⁴

Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Sigurisht, ky Kur'an është tryeza e Allahut, prandaj, studiojeni sa të mundeni tryezën e Tij.”⁵*

⁴ Sure “Zumer”, ajeti 27.

⁵ “Mustedreku Uesail”, vëll. 4, f. 232.

Kur'ani është depozita e dijeve të Allahut. Ai që ndriçohet me këtë dije dhe i mbart ato, do të jetë prej banorëve të Xhennetit. Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mbartësit e Kur'anit janë të diturit e banorëve të Xhennetit.”⁶

Transmetohet nga imam Sexhxxhadi (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: “Ajetet e Kur'anit janë depozitat e dijes. Sa herë që të hapësh një depozitë, ti duhet të shikosh se çfarë ka në të.”⁷

⁶ “Mustedrekul Uesail”, vëll. 4, f. 243.

⁷ “Mustedrekul Uesail”, vëll. 4, f. 238.

NDIKIMET DOBIPRURËSE TË KUR'ANIT

Cilido që e studion Kur'anin do të shohë ndikime të këndshme e dobiprurëse. Prej atyre ndikimeve janë:

1- Njohja e Allahut

Kjo çështje, e cila është themeli dhe baza e besimt të drejtë islam, përfshin një pjesë të madhe të Kur'anit të shenjtë dhe përmendet në forma të ndryshme. Njohja e Allahut është detyrë e të gjithë njerëzve. Kur'ani i Shenjtë e

përmend dhe e sqaron në disa ajete të tij çështjen e njohjes së Allahut të Madhëruar. Në Kur'an lexojmë: **“Nëse ti (o Muhamed) i pyet ata: “Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?”, me siguri që do të të thonë: “Allahu!”. Atëherë ti thuaju: “Qoftë lavdëruar Allahu!” Por, shumica e tyre nuk dinë.”** (Sure “Lukman”, ajeti 25)

Problemi i njerëzve është se ata nuk e njohim ashtu siç duhet njohur Krijuesin e tyre dhe nuk e vlerësojnë Atë ashtu siç e meriton dhe si pasojë ata nuk bësojnë dhe nuk e adhurojnë Atë. Këtë e dëshmon edhe Kur'ani i Shenjtë: **Ata nuk e vlerësojnë siç duhet Allahun...**⁸

⁸ Sure “En’am”, ajeti 91.

Transmetohet nga profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ka thënë: “Nëse do ta njihnit Allahu ashtu siç e meriton Ai njohjen, edhe malet e palëkundur do të zhduken me lutjen tuaj...”⁹

Sigurisht, njohja e Allahut arrihet duke medituar thellë në krijimin e Tij dhe në mirësitë e shumta me të cilat Ai i ka mirësuar krijesat e Tij. Arrihet duke menduar thellë në sistemin e krijimit të universit, i cili është krijuar me një precision të lartë e të mahnitshëm nga ana e Allahut të Plotfuëqishëm. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ti i shikon malet i mendon se janë të palëvizshme, por ato lëvizin si retë. E tillë është fuqia e Allahut, i Cili ka përsosur çdo gjë. Ai di mirë çdo gjë që bëni ju.”**¹⁰

⁹ “Auali Leali”, vëll. 4, f. 132.

¹⁰ Sure “Neml”, ajeti 88.

Prej argumenteve të njohjes së Allahut, që i përmend Kur'ani i Shenjtë, është krijimi i qiejve e i tokës dhe i gjithçaje që ndodhet në to, ndryshimi i natës dhe i ditës, ndryshimi i gjuhëve, i ngjyrave, etj.

Allahu i Madhëruar thotë: **Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t'u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt.”¹¹**

¹¹ Sure “Bekare”, ajeti 164.

Dhe: “Vërtet, në ndërrimin e natës me ditën dhe në atë që ka krijuar Allahu në qiej dhe në Tokë, ka shenja për njerëzit që i frikësohen Allahut.”¹²

Dhe: “Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë.”¹³

Dhe: “Të tjera shenja të Tij janë gjumi juaj natën e ditën dhe kërkesa e juaj nga dhuntitë e Tij. Vërtet, në këtë ka shenja për njerëzit që dëgjojnë.”¹⁴

¹² Sure “Junus”, ajeti 6.

¹³ Sure “Rrum”, ajeti 22.

¹⁴ Sure “Rrum”, ajeti 23.

Dhe: **“Gjithashtu, prej shenjave të Tij janë paraqitja e vetëtimës si frikë e shpresë dhe dërgimi i shiut prej qiellit, që nëpërmjet tij të gjallërohet toka pas shkretimit të saj. Sigurisht, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.”¹⁵**

Pasi Allahu sjell argumentet që vërtojnë se Ai është Krijuesi i gjithçkaje dhe Sunduesi Fuqiplot, i fton mohuesit që të sjellin argumentet e tyre nëse janë të vërtetë në mohimin e tyre. Allahu thotë: **“...atëherë sillni provën tuaj!”¹⁶**. Vërtet, kjo është një sfidë për të gjithë mohuesit dhe jobesimtarët e çdo kohe dhe çdo vendi.

Kur’ani i Shenjtë fton në teuhijd (Zoti është Një, i vetëm e i pashoq), i cili është në

¹⁵ Sure “Rrum”, ajeti 24.

¹⁶ Sure “Bekare”, ajeti 111.

përputhje me Qenien e Tij, atributet e Tij dhe me veprat e Tij. Ai thotë: **“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër** (të denjë për adhurim), Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti! Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim). Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqëdhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)! Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që çdo gjëje i jep trajtë. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”¹⁷

¹⁷ Sure “Hashr”, ajetet 22-24.

Kjo është ftesa e Kur'anit për të gjithë njerëzit. Cilido që e lexon Kur'anin do të mësojë se ai përdor dy gjuhë për përcjelljen e mesazheve të tij: gjuhën e logjikës dhe të zemrës. Kur'ani e konsideron logjikën argument për njerëzit dhe i fton që ta vënë në funksion dhe përfitojnë prej saj. Në të njëjtën kohë Kur'ani i qorton ata që nuk e përdorin logjikën e tyre dhe as që udhëzohen me anë të saj. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **“Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhe dhe memece (ndaj së vërtetës) e që nuk kanë arsye.”**¹⁸

Po ashtu, Kur'ani i Shenjtë përmend edhe pengesat që pengojnë njohjen e të

¹⁸ Sure “Enfal”, ajeti 22.

vërtetave, në krye të gjitha atyre qëndron njohja e Allahut të Madhëruar. Prej atyre janë:

1- Ndjekja e hamendësimit. Kur'ani thotë: **“Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi...”**¹⁹

2- Imitimi i baballarëve. Kur'ani thotë **“Kur atyre u thuhet: “Ndiqni atë që ka shpallur Allahu!” ata përgjigjen: “Jo! Ne do të ndjekim atë udhë në të cilën i kemi gjetur të parët tanë” - Vallë, edhe atëherë kur të parët e tyre nuk kuptonin gjë e nuk ishin të udhëzuar?!”**²⁰

3- Pasimi i egos. Në Kur'an lexojmë: **A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t'i bëhesh mbrojtës atij?”**²¹

¹⁹ Sure “Nexhm”, ajeti 23.

²⁰ Sure “Bekare”, ajeti 170.

²¹ Sure “Furkan”, ajeti 43.

Sa të shumtë janë të tillë njerëz sot në ditët tona! Kjo fatkeqësi gjendet edhe në mesin e muslimanëve, të cilët e themi me keqardhje, janë larguar nga fjala e Allahut të Madhëruar.

Kur'ani e fton njeriun në besim bazuar në argumente të shumta logjike. Ai i drejtohet natyrës së pastër të njeriut që gjithmonë të jetë e drejtuar kah Krijuesi i gjithësisë, Allahut të Plotfuqishëm.

Në Kur'an lexojmë: **“A ka më të mirë se Ai që e ka bërë Tokën të qëndrueshme, ka bërë në të lumenj, ka ngritur në të male dhe ka bërë midis dy deteve pengesë të padukshme?! Vallë, a ka krahas Allahut, zot tjetër?! Jo, por shumica e tyre janë të paditur. A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën juve trashëgimtarë**

në tokë?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Sa pak që reflektoni!”²²

Nëse njerëzit do të arrijnë ta njohin ashtu siç e meriton njohjen Allahu i Madhëruar, ata do ta besojnë, do ta adhurojnë dhe do t'i frikësohen Atij në vepra e në fjalë.

2- Njohja e Profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*)

Qëllimi me këtë njohje është që njerëzit të njihen me të dërguarit e Allahut dhe t'i marrin shembull e model në jetën e tyre. Në Kur'anin e shenjtë ka shumë histori të ndryshme që flasin për profetët, për thirrjen e

²² Sure “Neml”, ajetet 61-62.

tyre në rrugën e Allahut, për përballjet e tyre me popujt kokëfortë e jobesimtarë dhe për triumfin e tyre. Allahu i Madhëruar thotë: **“Para teje, Ne kemi dërguar vetëm burra nga banorët e qyteteve, të cilët i frymëzuam me shpallje...”**²³

Dhe: **“Në tregimet e atyre (të dërguarve) ka këshilla për ata që janë me mend...”**²⁴

Kur’ani i Shenjtë përdor metodën e historive në përcjelljen e kuptimeve, njohurive dhe qëllimeve të tij përshkak të ndikimit të madh që ka kjo metodë në zemrat e njerëzve. Kjo vërteton se Kur’ani i Shenjtë është në përputhje të plotë me natyrën, mendjen dhe zemrën e njerëzve.

²³ Sure “Jusuf”, ajeti 109.

²⁴ Sure “Jusuf”, ajeti 109.

Gjithashtu, në Kur'an lexojmë: **“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!” Disa prej tyre Allahu i shpuri në rrugë të drejtë e disa e merituan të mbeten në humbje. Prandaj, udhëtoni nëpër botë të shihni se si ishte fundi i përgënjeshtresve!”²⁵**

Historitë kur'anore përbëjnë një anë të rëndësishme të Kur'anit. Në disa hadithe thuhet se historitë janë një e treta e Kur'anit dhe shumica prej tyre janë historitë e profetëve (*Paqja qoftë mbi ta!*). Disa sure të Kur'anit janë emërtuar me emrat e profetëve si: Ibrahim, Hud, Junus, Nuh. Këto histori luajnë rol të madh në realizimin e qëllimeve të Kur'anit.

²⁵ Sure “Nahl”, ajet 36.

3- Njohja e Ringjalljes dhe qartësimi i çështjeve të saj

Prej çështjeve të rëndësishme që përmban Kur'ani i Shenjtë është ajo e Ringjalljes dhe argumentet që paraqet Kur'ani rreth vërtetësisë dhe patjetërsisë së asaj Jetës së Përtejme. Në të shumtën e rasteve, në Kur'anin e shenjtë, besimi në Jetën Tjetër është i shoqëron me besimin në Allahun e Madhëruar. Kur'ani i përshkruan besimtarët se ata janë që besojnë në Allahun në Ringjalljen dhe në Jetën Tjetër dhe i përshkruan jobesimtarët se ata nuk besojnë as në Allahun as në Ringjalljen e as në Jetën Tjetër.

Për të vërtetuar dhe për të konstatuar Ringjalljen dhe Jetën Tjetër, Kur'ani paraqet argument të qarta logjike e të dukshëm, që të zgjojë mohuesit dhe jobesimtarët prej gjumit të tyre të pavëmendshmërisë.

Në Kur'an lexojmë: **“Ne lëshojmë nga qielli ujë të bekuar dhe nëpërmjet tij krijojmë kopshte, drithëra që korren dhe palma hurme të larta me tufa frutash njëra mbi tjetrën, si ushqim për robërit Tanë; në këtë mënyrë Ne me shi e ringjallim tokën e vdekur. E kështu do të jetë edhe ringjallja.”**²⁶

Dhe: **“...Pastaj, kur t’ju thërrasë Ai, me një të thirrur, ju përnjëherë do të dilni nga toka (të ringjallur).”** (Sure “Rrum”, ajeti 25.)
“Atë Ditë, toka do të hapet e ata do të dalin

²⁶ Sure “Kaf”, ajetet 9-11.

me nxitim. Për Ne është e lehtë t'i mbledhim ata të gjithë." (Sure "Kaf", ajeti 44.) "Dhe, kur t'i fryhet Surit, ata do të dalin nga varret dhe do të nxisojnë drejt Zotit të tyre, duke thënë: 'Mjerë ne! Kush na ngriti prej varreve tona?'" (Do t'u thuhet): 'Ja, kjo është ajo që ka premtuar i Gjithëmëshirshmi; të dërguarit kanë thënë të vërtetën!' Do të jetë ai vetëm një zë i tmerrshëm e ata të gjithë do të paraqiten para Nesh."²⁷

Për konstatimin e kësaj çështjeje Kur'ani paraqet edhe ndodhi historike si ajo e banorëve të shpellës, e Uzejrit, të cilin Allahu e vdiq njëqind vjet pastaj e ringjalli atë. Gjithashtu, Kur'ani kur flet për Jetën Tjetër, e paraqet atë si diçka të prekshme ku njeriu e përfytyron veten e tij në të dhe i shikon me sytë

²⁷ Sure "Jasin", ajetet 51 - 53.

e tij bukuritë e Xhennetit apo tmerrin e Xhehenemit. Ai thotë: **“Vërtet, besimtarët e devotshëm do të jenë në kopshtet e Xhenetit, ku rrjedhin lumenj, në kuvendin e së vërtetës (në Xhennet), tek një Sundues i Plotfuqishëm.”**²⁸

Dhe: **“Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumni dhe një mbretëri të madhe. Ata do të jenë të veshur me petka të holla mëndafshi të gjelbër dhe me armaç mëndafshi të trashë, të stolisur me byzylykë të argjendtë. Zoti i tyre do t’u japë të pinë pije të pastër. Ky do të jetë me të vërtetë shpërblimi juaj; përpjekjet tuaja do të jenë të pranuar. Në të vërtetë, Ne ta kemi shpallur Kur’anin ty hap pas hapi.”**²⁹

²⁸ Sure “Kamer”, ajetet 54 – 55.

²⁹ Sure “Insan”, ajetet 20 -23.

Allahu i Madhëruar na urdhëron që të ruajmë vetat tona dhe familjet tona nga zjarri i Xhehenemit, të cilin e përshkruan si vijon: **O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.**"³⁰

³⁰ Sure "Tahrim", ajeti 6.

4- Udhëzimi nga humbja e devijimi

Kur'ani i Shenjtë është drita udhëzuese e Allahut dhe shpëtuesi nga humbja dhe devijimi. Allahu i Madhëruar thotë: **Në të vërtetë, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.**"³¹

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi te dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"Unë kam lënë në mesin tuaj dy gjëra të rënda (me vlerë). Nëse kapeni pas tyre, ju kurrë nuk do të humbisni, Librin e Allahut dhe gjenezën time, Ehli Bejtin tim. Ato të dyja kurrë nuk do të ndahen*

³¹ Sure "Isra", ajeti 9.

*derisa të vijnë te unë te Haudi (burimi i Keutherit)."*³²

³² Ky hadith është transmetuar me këtë term dhe me terma të tjerë në mënyrë konsekuente (*muteuatir*) sipas kuptimit në: *Sahijhu Muslim*, 4: 1873/2408 dhe 5: 663/3786 dhe 3788. *El-Mustedrek* i Hakimit, 3: 148. *Musnedu Ahmed*, 3: 14, 17, 26, 59 dhe 4: 371, 5: 182 dhe 189. *Fadailu's-Sahabe* i Ahmed ibn Hanbelit, 2: 603/ 1035. *El-Khasais* i Nisaijut, 21. *Mesabijhu's-Sunneh*, 4: 185/4800 dhe 190/4816. *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9: 163-164. *El-Xhamiu's-Sagijr* i Sujutijut, 1: 244/1608. *Es-Sauaiku'l-Muhrika* i Ibn Haxherit, 75 dhe 89. *El-Khasaisu'l-Kubra* i Sujutijut, 2: 266. *Tefsiri Ed-Durru'l-Menthur* i Sujutijut, 2: 60. *Tefsijru'r-Razij*, 8: 163. *Hiljetu'l-Eulija*, 1: 355. *Sunenu'l-Bejhakij*, 2: 148 dhe 7: 30. *Usdu'l-Gabeh*, 2: 13. *Tarijkhul Bagdad*, 8: 442. *El-Mu'xhemu'l-Kebijr* i Taberanijut, 3: 201/3052 e shumë të tjerë.

5- Lartësimi në Jetën Tjetër

Çdo ajet prej ajetve të Kur'anit të shenjtë përfaqëson një shkallë prej shkallëve të Xhennetit. Sa herë që një njeri lexon apo studion një ajet nga Libri i Allahut, Kur'ani i Shenjtë, atë herë ngjitet në shkallët e Xhennetit. Transmetohet nga profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij se ka thënë: *“Numri i shkallëve të Xhennetit është sa numri i ajeteve të Kur'anit. Kur mbartësi i Kur'anit të hyjë në Xhennet do t'i thuhet: Lexo e ngjitu. Për çdo ajet ka një një shkallë. Mbi hafizin e Kur'anit nuk ka më shkallë.”*

6- Shërimi

Kur'ani i Shenjtë është shërues i vërtetë i sëmundjeve shpirtërore. Ai largon sëmundjet e zemrave. Ai është oksigjeni i lumturisë në të dyja jetët. Cilido që kërkon të pastrojë të brendshme e tij prej sëmundjeve, papastërtive dhe gjynaheve, ai duhet të ndjekë dritën e Allahut, Fjalën e Tij, Kur'anin e shenjtë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne shpallim nga Kur'ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.”**³³

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: *“Mësojeni Kur'anin sepse ai është pranvera e*

³³ Sure “Isra”, ajeti 82.

zemrave. Kërkoni shërim me dritën e tij sepse ai është shërues i kraharrëve.”³⁴

7- Shpëtimi nga dënimi

Vërtet, Allahu i Madhëruar nuk e dënon atë njeri që e mëson, e mbart dhe e zbaton Kur'anin. Sepse një njeri i tillë është bërë Kur'an lëvizës në çdo hap që hedh në jetë dhe Kur'ani është bërë mbrojtësi i tij. Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Lexojeni Kur'anin dhe shfaqeni atë (në vepra e në fjalë) sepse Allahu nuk e dënon atë zemër që mbart Kur'anin.”³⁵

³⁴ “Uesailu shiia”, vëll. 6, f. 167.

³⁵ “Uesailu shiia”, vëll. 4, f. 245.

Profeti Muhamed dhe Ehli Bejti i tij i pastër (*Paqja qoftë mbi ta!*) na ka lënë një trashëgimi të madhe e të vyer. Ata na kanë sqaruar dispozitat dhe rregullat e Islamit të pastër. Një prej trashëgimive të tyre janë edhe thëniet e tyre për Kur'anin e Shenjtë, duke na sqaruar pozitën e Kur'anit, mirësitë e mësimin, studimit, meditimit dhe të zbatimit të tij në jetën tonë të përditëshme.

Për këtë Fondacioni i Kur'anit ka mbledhur, ka përkthyer thënie të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) si dhe thënie nga Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) që flasin për Kur'anin e Shenjtë. ***Thëniet janë marrë nga faqja e internetit: <https://ar.al-shia.org/>***

Me këtë rast, Fondacioni i Kur'anit falënderon të gjithë bashkëpuntorët që

ndihmuan në përgatitjen e këtij libërthi, i vogël në volum por i madh nga përmbajtja e tij. Allahu u dhëntë suksese e mirësi në këtë dhe i shpërbleftë me Xhennet në Jetën Tjetër!

Allahu na e ndriçoftë këtë jetë me dritën e Kur'anit dhe na dhuroftë ndërmjetësimin e Kur'anit në Jetën Tjetër!

Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

dhe të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi të!)

**KUR'ANI NË THËNIET E
PROFETIT DHE TË EHLI BEJTIT**
(Paqja qoftë mbi ta!)

1- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), duke përkthyer Kur'anin, ka thënë: “Allahu e bëri atë (Kur'anin) shaurës për etjen e dijetarëve, pranverë për zemrat e juristëve, udhëzues për rrugët e të mirëve, ilaç pas të cilit nuk ka sëmundje, dhe dritë me të cilën nuk ka errësirë.” Burimi: “Nehxhul Belaga”, Hytbja 198; “Sherhu Nehxhul Belaga”, Ibn Ebil Hadijd, vëll. 10, f. 199.

1- قال الإمام علي (عليه السلام) - في صفة القرآن -: جعله الله ربا لعطش العلماء، وربيعا لقلوب الفقهاء، ومحاج لطرق الصالحاء، ودواء ليس بعده داء، ونورا ليس معه ظلمة.

نهج البلاغة: الخطبة 198، شرح نهج البلاغة لابن أبي الحديد: 10 / 199.

2- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Dijeni se ky Kur’an është këshilluesi që nuk mashtron, udhërrëfyeni që nuk gabon dhe tregimtari që nuk gënjen. Kushdo që e shoqëron këtë Kur’an, ngrihet prej tij me shtim ose pakësim: shtim në udhëzim, ose pakësim në verbëri (shpirtërore).” (“Nehxhul Belaga”, Hytbja 176; komentuar nga Ibn Ebil Hadijd, vëll. 10, f. 18)

2- قال الإمام علي (عليه السلام): اعلّموا أن هذا القرآن هو الناصح الذي لا يغش، والهادي الذي لا يضل، والمحدث الذي لا يكذب، وما جالس هذا القرآن أحد إلا قام عنه بزيادة أو نقصان، زيادة في هدى، أو نقصان من عمى.

نهج البلاغة: الخطبة 176، نهج البلاغة لابن أبي الحديد: 18 / 10.

3- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Vërtet, Allahu i Lartësuar nuk e ka këshilluar askënd me diçka më të vlefshme sesa ky Kur’an. Ai është litari i fortë i Allahut dhe lidhja e Tij e sigurt. Në të gjendet pranvera e zemrës dhe burimet e dijes, dhe zemra nuk gjen pastrim përveçse në të.” (“Nehxhul Belaga”, Hytbja 176; komentuar nga Ibn Ebil Hadijd, vëll. 10, f. 31)

3- قال الإمام علي (عليه السلام): إن الله سبحانه لم يعط أحدا بمثل هذا القرآن، فإنه جبل الله المتين وسببه الأمين، وفيه ربيع القلب، وينابيع العلم، وما للقلب جلاء غيره.

نهج البلاغة: الخطبة 176، شرح نهج البلاغة لابن أبي الحديد: 10 / 31.

4 - Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Përkujtimi më i mirë është Kur’ani. Me të
hapen gjokset dhe ndriçohen zemrat e
fshehta.”

(“Gurarul Hikem”, nr. 3255)

4- قال الإمام علي (عليه السلام): أفضل الذكر القرآن، به تشرح الصدور،
وتستنير السرائر.

غرر الحكم: 3255.

5 – Imam Zejnul Abidini (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Edhe nëse do të vdisnin të gjithë nga lindja në perëndim, unë nuk do të ndihesha i vetmuar, përderisa Kur’ani është me mua.” (“El Kafi”, vëll. 2, f. 602, nr. 13)

5- قال الإمام زين العابدين (عليه السلام): لو مات من بين المشرق والمغرب
لما استوحشت بعد أن يكون القرآن معي.

الكافي: 2 / 602 / 13.

6 – Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Kush nuk e njeh të vërtetën përmes Kur’anit,
nuk do të shpëtojë nga sprovat (dallgët e
fitneve).”

(“El Mehasin, vëll. 1, fq. 341, nr. 702)

6- قال الإمام الصادق (عليه السلام): من لم يعرف الحق من القرآن لم
يتنكب الفتن.

المحاسن: 1 / 341 / 702.

7 - Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Kur’ani është udhëzimi më i mirë ndër të dy
udhëzimet.”

(“Gurarul Hikem”, nr. 1664)

7- قال الإمام علي (عليه السلام): القرآن أفضل الهدايتين.

غرر الحكم: 1664.

8 – Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Për Allah, për Allah! Kujdesuni për Kur’anin! Mos lejoni që të tjerët t’ju tejkalojnë në veprimin sipas tij.” (“Nehxhul Belaga”, Letra 47)

8- قال الإمام علي (عليه السلام): الله الله في القرآن، لا يسبقكم بالعمل به
غيركم.

نهج البلاغة: الكتاب 47.

Kur'ani është fjala më e vertete

9- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Fjala më e vërtetë, këshilla më elekuente dhe tregimi më i bukur është Libri i Allahut.” (“El Fakijh”, vëll. 4, f. 402, nr. 5868)

9- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): أصدق القول وأبلغ الموعظة وأحسن القصص كتاب الله.

الفقيه: 4 / 402 / 5868.

10 - Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Mësojeni Librin e Allahut, të Lartësuar dhe të
Bekuar, sepse ai është fjala më e bukur dhe
këshilla më elekuente. Thellohuni në kuptimin
e tij, sepse ai është pranvera e zemrave.
Kërkoni shërim me dritën e tij, sepse ai është
shërim për ato që ndodhen në kraharrorë. Dhe
lexojeni bukur atë, sepse ai përmban tregimet
më të bukura.”

(Tuheful Ukul, f. 150)

10- قال الإمام علي (عليه السلام): تعلموا كتاب الله تبارك وتعالى فإنه
أحسن الحديث وأبلغ الموعظة، وتفقهوا فيه فإنه ربيع القلوب، واستشفوا بنوره
فإنه شفاء لما في الصدور، وأحسنوا تلاوته فإنه أحسن القصص.

تحف العقول: 150.

11- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mirësia e Kur’anit ndaj gjithë fjalëve të tjera është si mirësia e Allahut ndaj krijesave të Tij.” (Biharul Anuar, vëll. 92, f. 19, nr. 18)

11- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): فضل القرآن على سائر الكلام كفضل الله على خلقه.

البحار: 92 / 19 / 18.

12- Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*), në përshkrimin e Kur'anit ka thënë: “Ai është litari i fortë i Allahut, kapja e sigurt (e palëkundshme), rruga më e mirë, që të çon në Xhennet dhe të shpëton nga Zjarri. Nuk vjetrohet me kalimin e kohës, as nuk bëhet i mërzitshëm për gjuhët, sepse nuk është për një kohë të caktuar, por është tregues i qartë dhe argument për çdo njeri. Asgjë e rreme nuk i vjen as përpara as pas tij, është Shpallje nga i Urti dhe i Denji për lavdërim.” (Ujun Akhbar Er Rida, vëll. 2, f. 130, hadithi nr. 9)

12- قال الإمام الرضا (عليه السلام) - في صفة القرآن :-
هو جبل الله المتين، وعروته الوثقى، وطريقته المثلى، المؤدي إلى الجنة،
والمنجي من النار، لا يخلق على الأزمنة، ولا يغث على الألسنة، لأنه لم يجعل
لزمان دون زمان، بل جعل دليل البرهان، والحجة على كل إنسان، لا يأتيه
الباطل من بين يديه ولا من خلفه تنزيل من حكيم حميد.
عيون أخبار الرضا (عليه السلام): 2 / 130 / 9.

Kur'ani është shërim nga sëmundja më e madhe.

13- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në të (në Kur'an) ka shërim nga sëmundja më e madhe, e ajo është mosbesimi (kufri), hipokrizia (nifaku), devijimi dhe humbja në rrugë të gabuar.” (“Nehxhul Belaga”, Hytbja 176; “Sherh Nehxhul Belaga” i Ibn Ebi El Hadijd”, vëll. 10, f. 19)

القرآن شفاء من أكبر الداء

13- قال الإمام علي (عليه السلام): إن فيه شفاء من أكبر الداء، وهو الكفر والنفاق، والغي والضلال.

نهج البلاغة: الخطبة 176، شرح نهج البلاغة لابن أبي الحديد: 10 / 19.

14- Imam Hasani (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Ky Kur’an përmban drita ndriçuese dhe
shërim për krahavorët.” (Burimi: “Biharul
Anuar”, vëll. 78, f. 112, hadithi 6)

14- قال الإمام الحسن (عليه السلام): إن هذا القرآن فيه مصابيح النور
وشفاء الصدور.

البحار: 78 / 112 / 6.

15- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Kapuni fort pas Librit të Allahut, sepse ai
është litari i fortë, drita e qartë dhe shërimi i
dobishëm... Kush flet sipas tij, flet të vërtetën,
dhe kush vepron sipas tij, del përpara.”

(Nehxhul Belaga, Hutba 156; Sharh Nehxhul
Belaga nga Ibn Ebi el-Hadid: 9/203)

15- قال الإمام علي (عليه السلام): عليكم بكتاب الله، فإنه الجبل المتين،
والنور المبين والشفاء النافع... من قال به صدق، ومن عمل به سبق.
نهج البلاغة: الخطبة 156، شرح نهج البلاغة لابن أبي الحديد: 9 / 203.

القرآن غني لا غنى دونه

16- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kur’ani është pasuri, nuk ka pasuri (të vërtetë) pa të dhe nuk ka varfëri pas tij.” (Biharul Anuar, vëll. 92, f. 19, nr. 18)

16- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): القرآن غنى، لا غنى دونه، ولا فقر بعده.

البحار: 92 / 19 / 18.

17- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Kujtdo që i është dhënë Kur'ani (mësimi i tij, studimi i tij, apo hifzi i tij) dhe mendon se dikujt tjetër i është dhënë diçka më e madhe se ajo që i është dhënë atij, ai e ka madhëruar të voglën dhe e ka zvogëluar të madhën." (Burimi: "Me'anij El Akhbar, f. 279.)

17- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): من أعطي القرآن فظن أن أحدا أعطي أكثر مما أعطي فقد عظم صغيرا وصغر كبيرا.

معاني الأخبار: 279.

ما في القرآن من العلوم والأخبار

18- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në Kur’an gjendet lajmi për ata që ishin para jush, lajmërimi për ato që do të vijnë pas jush, dhe gjykimi për ato që janë mes jush.”

Burimi: “Nahxhul Belaga, urtësia nr. 313; “Sherhu Nehxhul Belaga” i Ibn Ebi El Hadid, vëllimi 19, f. 220.

18- قال الإمام علي (عليه السلام): في القرآن نبأ ما قبلكم، وخبر ما بعدكم،
وحكم ما بينكم.

نهج البلاغة: الحكمة 313، شرح نهج البلاغة لابن أبي الحديد: 19 / 220.

19- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Vërtet, në të (në Kur'an) gjendet dija për atë që
do të vijë, rrëfimi për të kaluarën, shërimi i
sëmundjeve tuaja dhe rregullat ndërmjet jush."

"Nehxhul Belaga", Hytbja 158; "Sherh
Nehxhul Belaga", i Ibn Ebil Hadid, vëll. 9, f.
217.

19- قال الإمام علي (عليه السلام): ألا إن فيه علم ما يأتي، والحديث عن
الماضي، ودواء داءكم، ونظم ما بينكم.

نهج البلاغة: الخطبة 158، شرح نهج البلاغة لابن أبي الحديد: 9 / 217.

20- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush dëshiron dijen e të parëve dhe të mëvonshmëve, le ta lexojë Kur’anin.”

Burimi: “Kenzul Ummal”, nr. 2454.

20- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): من أراد علم الأولين والآخرين
فليقرأ القرآن.

كنز العمال: 2454.

Mësimi i Kur'anit

21- Imami Sadik (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Besimtari nuk duhet të vdesë pa e mësuar
Kur'anin, ose të jetë në proces të mësimin të tij.”
(Ed Deu'atu Er Rauendi, f. 220, nr. 600)

تعلم القرآن

21- قال الإمام الصادق (عليه السلام): ينبغي للمؤمن أن لا يموت حتى يتعلم القرآن، أو يكون في تعلمه.

الدعوات للراوندي: 220 / 600.

22- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Nëse dëshironi jetën e të lumturve, vdekjen e dëshmorëve, shpëtimin në Ditën e Pikëllimit, hijen në Ditën e vapës së mdhe dhe udhëzimin në ditën e humbjes, atëherë mësoni Kura’nin. Sepse ai është fjala e të Gjithëmëshirshmit, mburojë nga shejtani dhe peshë e rëndë në peshore (e veprave).”

(Burimi: “Biharul Anuar”, vëll. 92, f. 19, hadithi nr. 18)

22- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): إن أردتم عيش السعداء وموت الشهداء والنجاة يوم الحسرة والظل يوم الحرور والهدى يوم الضلالة فادرسوا القرآن، فإنه كلام الرحمن وحرز من الشيطان ورجحان في الميزان.

البحار: 92 / 19 / 18.

23- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Do t’i thuhet atij që është shoqëruar me Kur’anin: ‘Lexo, ngjitu dhe recito ashtu siç recitoje në jetën e kësaj bote, sepse vendbanimi yt (në Xhenet) do të jetë te ajeti i fundit që e ke lexuar.”
(Referenca: “Kenzul Ummal”, nr. 2330)

23- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): يقال لصاحب القرآن: اقرأ وارق ورتل كما كنت ترتل في دار الدنيا، فإن منزلتك عند آخر آية كنت تقرأها.
كنز العمال: 2330.

Shpërblimi i mësimit të Kur'anit

24- Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kushdo që i mëson një njeriu një ajet nga Libri i Allahut, Kur’ani, ai bëhet mbrojtës i tij. Nuk i lejohet ta braktisë atë (nxënësin) dhe as të sillet egoist ndaj tij. Nëse e bën këtë, ka këputur një hallkë nga hallkat e Islamit.”

(*Kenzu’l Ummal, nr. 2384*)

ثواب تعليم القرآن

24- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): من علم عبدا آية من كتاب الله فهو مولاه، لا ينبغي له أن يخذله ولا يستأثر عليه، فإن هو فعله قصم عروة من عرى الإسلام. (كنز العمال: 2384).

25- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: Kur një grup njerëzish mbledhen në një nga shtëpitë e Allahut (xhamitë), për të lexuar Librin e Allahut dhe për ta studiuar atë së bashku, mbi ta zbret qetësia, i mbulon mëshira, i rrethojnë engjëjt dhe i përmend Allahu me ata që janë pranë Tij. (Kenzul Ummal: 2320)

25- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

ما اجتمع قوم في بيت من بيوت الله يتلون كتاب الله ويتدارسونه بينهم إلا نزلت عليهم السكينة، وغشيتهم الرحمة، وحققهم الملائكة، وذكرهم الله فيمن عنده.

كنز العمال: 2320.

26- Profeti Muhamed (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë:
“Kush e mëson Kur’anin, ia mëson të tjerëve dhe vepron sipas tij, unë do të jem udhëheqësi i tij drejt Xhennetit dhe udhërrëfyes për në të (Xhennet).”
(*Kenzu’l-Ummal*, nr. 2375)

26- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): ألا من تعلم القرآن وعلمه وعمل بما فيه فأنا له سائق إلى الجنة ودليل إلى الجنة.

كنز العمال: 2375.

27- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush ia mëson fëmijës së tij Kur’anin, Allahu do t’i vendosë atij (prindit) një varëse që do t’i mahnitë të parët dhe të fundit në Ditën e Kiametit.” (Kenzul Ummal, nr. 2386)

27- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): من علم ولدا له القرآن قلده الله قلادة يعجب منها الأولون والآخرون يوم القيامة.

كنز العمال: 2386.

28- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “E drejta e fëmijës ndaj prindit është që t’i zgjedhë një emër të mirë, ta edukojë mirë dhe t’ia atij mësojë Kur’anin.” Burimi: “Nehxhul Belaga”, Urtësia 399.

28- قال الإمام علي (عليه السلام): حق الولد على الوالد أن يحسن اسمه،
ويحسن أدبه، ويعلمه القرآن.

نهج البلاغة: الحكمة 399.

Mirësia e leximit të Kur'anit në vegjëli

29- “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: Kush e lexon Kur'anin para se të arrijë pubertetin, ai është pajisur me urtësi që në fëmijëri.”

Burimi: “Kenzul Ummal”, hadithi nr. 2452

29- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): من قرأ القرآن قبل أن يحتلم فقد أوتي الحكم صيباً.

كنز العمال: 2452.

Nxitja për të mësuar përmendësh Kur'anin

30- “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Ai që nuk ka asgjë nga Kur’ani në kraharorin e tij është si një shtëpi e rrënuar.”
(Burimi: “Kenzul Ummal”: 2478)

الحث على حفظ القرآن

30- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): إن الذي ليس في جوفه شيء من القرآن كالبيت الخرب.

كنز العمال: 2478.

Në një nga lutjet e tij i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “O Allah, më mëshiro duke më bërë që të heq dorë nga mëkatet e Tua për sa kohë që më jep jetë! Më dhuro të shoh e të kuptoj qartë ato që të kënaqin Ty nga unë! Bëje zemrën time të qëndrojë e lidhur pas Librit Tënd, ashtu siç më ke mësuar! Bëje që ta lexoj atë në mënyrën që Ty të kënaq! O Allah, ndriçoje shikimin tim me Librin Tënd, më hap kraharorin me të, më gëzo zemrën me të, më lësho gjuhën me të, vëre në shërbim trupin tim me të dhe më jep fuqi për këtë, sepse nuk ka forcë dhe fuqi përveçse me Ty!”

Burimi: “Kurbul Isnād”, vëll. 5, f. 16.

31- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله) - من دعائه -: اللهم ارحمني بترك معاصيك أبدا ما أبقيتني، وارزقني حسن النظر فيما يرضيك عني، وألزم قلبي حفظ كتابك كما علمتني، واجعلني أتلوه على النحو الذي يرضيك عني، اللهم نور بكتابك بصري، واشرح به صدري، وفرح به قلبي، وأطلق به لساني، واستعمل به بدني، وقويني على ذلك، فإنه لا حول ولا قوة إلا بك.

قرب الأسناد: 5 / 16.

Shpërblimi i mbartësve të Kur'anit

32- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mbartësit e Kur'anit janë të rrethuar me mëshirën e Allahut dhe janë të veshur me dritën e Allahut të Lartësuar.”

(Burimi: “Xhamiul Akhbar, f. 115 / hadithi 202)

جزاء حملة القرآن

32- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

حملة القرآن هم المحفوفون برحمة الله، الملبسون بنور الله عز وجل.

جامع الأخبار: 115 / 202.

33- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Mbartësit e Kur'anit janë njohësit (arifat) e banorëve të Xhenetit, luftëtarët në rrugën e Allahut janë drejtuesit e tij, ndërsa të dërguarit janë zotërinjtë e banorëve të Xhenetit."

Burimi: Mustedrek El Uesa'il, vëll. 11, f. 7, hadithi nr. 12275.

33- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

حملة القرآن عرفاء أهل الجنة، والمجاهدون في سبيل الله قوادها، والرسول
سادة أهل الجنة.

مستدرک الوسائل: 11 / 7 / 12275.

34- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Fisnikët e umetit tim janë mbartësit e Kur’anit dhe ata që e kalojnë natën (në adhurim).”

Burimi: “El Khisal”, vëll. 1, f. 21, hadithi nr. 34.

34- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

أشرف أمتي حملة القرآن وأصحاب الليل.

الخصال: 7 / 21.

35- Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mbartësit e Kur’anit janë mësuesit e fjalës së Allahut dhe të mbështjellët me dritën e Tij. Kush i do ata, don Allahun, dhe kush i armiqëson ata, ka armiqësuar Allahun.” (*“Kanzul -‘Ummāl”, nr. 2345*)

35- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): حملة القرآن هم المعلمون كلام الله، والمتلبسون بنور الله، من والاهم فقد والى الله، ومن عاداهم فقد عادى الله.

كنز العمال: 2345.

36- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Me të vërtetë këto zemra ndryshken ashtu siç ndryshket hekuri.” U tha: “O i Dërguar i Allahut, çfarë është pastrimi i tyre?” Ai tha: “Leximi i Kur’anit.”

(“Kenzul Ummal”: 2441)

الحث على تلاوة القرآن

36- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

إن هذه القلوب تصدأ كما يصدأ الحديد، قيل: يا رسول الله فما جلاؤها ؟
قال: تلاوة القرآن.

كنز العمال: 2441.

37- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Kushdo që gjen qetësi duke lexuar Kur’anin
nuk do të ndihet i vetmuar nëse është i ndarë
nga miqtë e tij.” (“Gurarul Hikem”, hadithi
8790)

37- قال الإمام علي (عليه السلام): من أنس بتلاوة القرآن لم توحشه مفارقة
الإخوان.

غرر الحكم: 8790.

38- “I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Zbatoje leximin e Kur’anit, sepse leximi i tij është shlyerje për mëkatet, mburojë nga zjarri (i Xhehenemit), dhe siguri nga dënimi.”

(Biharul-Envar, vëll. 92, fq. 17, nr. 18)

38- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): عليك بقراءة القرآن، فإن قراءته كفارة للذنوب، وستر في النار، وأمان من العذاب.

البحار: 92 / 17 / 18.

39- “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush e lexon Kur’anin, është sikur profecia të ishte tërhequr mes dy anëve të tij, me përjashtim se nuk i shpallet (zbritet) shpallja.”

(Kanzul Ummal: 2349)

39- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): من قرأ القرآن فكأنما استدرجت النبوة بين جنبيه، غير أنه لا يوحى إليه.

كنز العمال: 2349.

40- Kur imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e mbaronte së lexuari të gjithë Kur'anin thoshte: "O Allah, zgjeroje gjoksin tim me Kur'anin, përdore trupin tim në shërbim të Kur'anit, ndriçoje shikimin tim me Kur'anin, liroje gjuhën time me Kur'anin dhe më ndihmo ta zbatoj atë për aq kohë sa të më mbash gjallë, sepse nuk ka forcë e as fuqi përveç Teje."

Burimi: "Biharul Anuar", vëll. 92, f. 209, hadithi nr. 6.

40- قال الإمام علي (عليه السلام) - عند ختمه القرآن :-

اللهم اشرح بالقرآن صدري، واستعمل بالقرآن بدني، ونور بالقرآن بصري، وأطلق بالقرآن لساني، وأعني عليه ما أبقيتني، فإنه لا حول ولا قوة إلا بك.

البحار: 92 / 209 / 6.

Etika e leximit të Kur'anit – Pastrimi i gojës

41 - I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Gjatë juaj janë rrugë e Kur'anit, prandaj pastrojeni atë me misvak.” (Burimi: “Kenzul Ummal”, 2751)

آداب القراءة

1 – تنظيف الفم:

41- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): إن أفواهكم طرق القرآن فطيبوها بالسواك.

كنز العمال: 2751.

42- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): طيبوا أفواهكم، فإن أفواهكم طريق القرآن.

كنز العمال: 2752.

43- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Mbyllni dyert e mëkatit me kërkimin e mbrojtjes (nga Allahu), dhe hapni dyert e bindjes (ndaj Tij) me përmendjen e Emrit të Tij (me Bismilah).”

Burimi: Biharul Anuar, vëll. 92, f. 216, hadithi nr. 24.

2 – الاستعاذة:

43- قال الإمام الصادق (صلى الله عليه وآله): أغلقوا أبواب المعصية بالاستعاذة، وافتحوا أبواب الطاعة بالتسمية.

البحار: 92 / 216 / 24.

Recitimi i Kur'anit

44- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në librin “Nehxhul Balaga”, Hytbja 193, i përshkruan të devotëshmit (muttakinët) duke thënë: “Sa i përket natës, ata qëndrojnë në këmbë (në falje), duke recituar pjesë nga Kur’ani, e recitojnë atë me përpikëri. Me të trishtojnë veten e tyre dhe me të zgjojnë shërimin për sëmundjen e tyre.”

3 – الترتيل:

44- قال الإمام علي (عليه السلام) – في صفة المتقين –: أما الليل فصافون أقدامهم، تالين لأجزاء القرآن يرتلون ترتيلاً، يحزنون به أنفسهم، ويستثيرون به دواء دائم.

نهج البلاغة: الخطبة 193.

45- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Me të vërtetë, nuk ka kurrfarë të mire në një
lexim (të Kur'anit) pa meditim. Me të vërtetë,
nuk ka kurrfarë të mire në një adhurim pa
kuptim të thellë.”

Burimi: “Biharul Anëar”, vëll. 92, f. 211, hadithi
nr. 4:

4 – التدبر:

45- قال الإمام علي (عليه السلام): ألا لا خير في قراءة ليس فيها تدبر، ألا
لا خير في عبادة ليس فيها تفقه.

البحار: 92 / 211 / 4.

46- Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Meditoni mbi ajetet e Kur’anit dhe merrni
mësim prej tij, sepse ai është më i fuqishmi
ndër mësimet.”

Burimi: “Gurarul Hikem”, hadithi nr. 4493

46- قال الإمام علي (عليه السلام): تدبروا آيات القرآن واعتبروا به، فإنه أبلغ
العبر.

غرر الحكم: 4493.

Frikërespekti në leximin e Kur'anit

47- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Unë vërtet çuditem se si nuk thinjem kur e lexoj Kur'anin.”

Burimi: “Biharul Anuar”, vëll. 16, f. 258, hadithi nr. 42.

5 – الخشوع:

47- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): إني لأعجب كيف لا أشيب إذا قرأت القرآن.

البحار: 16 / 258 / 42.

48- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Ai sy që loton nga leximi i Kur’anit, do të kënaqet në Ditën e Rinjalljes.” Burimi: “Kenzul Ummal”, hadithi nr. 2824.

48- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): ما من عين فاضت من قراءة القرآن إلا قرت يوم القيامة.

كنز العمال: 2824.

49- Kur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u pyet për atë që ka leximin më të mire, ka thënë: “Kur e dëgjon leximin e tij, e kupton se ai ka frikërespekt të thellë ndaj Allahut.”³⁶

49- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله) - لما سئل عن أحسن الناس قراءة :-

إذا سمعت قراءته رأيت أنه يخشى الله.

كنز العمال: 4143.

³⁶ “Kenzul Ummal”, hadithi nr. 4143.

50- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Në Xhehenem ka një mulli prej hekuri, me të cilin bluhën kokat e lexuesve (të Kur’anit) dhe dijetarëve mëkatarë (kriminelë).”³⁷

القراء الفجرة

50- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): إن في جهنم رحاء من حديد تطحن بها رؤوس القراء، والعلماء المجرمين.

جامع الأخبار: 130 / 254.

³⁷ “Xhami’ul Akhbari”, f. 130, hadithi 254.

Leximi i Kur'anit tek prijësi i padrejtë

51- Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kush hyn te një prijës i padrejtë dhe i lexon atij Kur'anin duke synuar me këtë diçka nga përfitimet e kësaj bote, për çdo shkronjë lexuesi mallkohet me dhjetë mallkime, dhe dëgjuesi mallkohet për çdo shkronjë me një mallkim.”³⁸

51- قال الإمام الباقر (عليه السلام): من دخل على إمام جائر فقرأ عليه القرآن يريد بذلك عرضاً من عرض الدنيا لعن القارئ بكل حرف عشر لعنات، ولعن المستمع بكل حرف لعنة. الاختصاص: 262.

³⁸ “El Ihtisas”, f. 262.

52- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush e mëson Kur’anin për (të fituar) dynjanë dhe stolitë e saj, Allahu ia ndalon atij Xhennetin.”³⁹

52- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): من تعلم القرآن للدنيا وزينتها حرم الله عليه الجنة.

البحار: 77 / 100 / 1.

³⁹ “El Bihar”, vëll. 77, f. 100, hadithi nr. 1.

Llojet e lexuesve të Kur'anit

53- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: Lexuesit e Kur'anit janë tre llojesh: Ai që e lexon Kur'anin për të fituar favore nga mbretërit dhe për të fituar epërsi mbi njerëzit. Ky është prej banorëve të zjarrit. Ai që e lexon Kur'anin dhe kujdeset për shkronjat e tij, por i shpërfill kufijtë dhe urdhrat e tij. Edhe ky është prej banorëve të Zjarrit. Ai që e lexon Kur'anin dhe e mban atë si mbulesë nën mantelin e tij: vepron sipas pjesëve të qarta të tij, beson në të paqartat, i përmbush obligimet, e lejon të lejuarën dhe e ndalon të ndaluarën. Ky është prej atyre që Allahu e shpëton nga sprovat

mashtuese dhe është prej banorëve të Xhenetit. Ai, gjithashtu, do të ndërmjetësojë për kë të dojë.”⁴⁰

أصناف القراء

53- قال الإمام الصادق (عليه السلام):

القراء ثلاثة: قارئ قرأ القرآن ليستدر به الملوك ويستطيل به على الناس
فذاك من أهل النار، وقارئ قرأ القرآن فحفظ حروفه وضع حدوده فذاك من
أهل النار، وقارئ قرأ القرآن فاستتر به تحت برنسه فهو يعمل بمحكمه ويؤمن
بمتشابهه ويطيع فرائضه ويحل حلاله ويحرم حرامه فهذا ممن ينقذه الله من
مضلات الفتن وهو من أهل الجنة ويشفع فيمن شاء.

الخصال: 1 / 143 / 165.

⁴⁰ “El Khisalu”, vëll. 1, f. 143, nr. 165.

54- Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ka nga ata njerëz që e mësojnë Kur'anin që të thuhet: ‘Filani është lexues (i mirë)’. Disa të tjerë e mësojnë atë për të kërkuar një zë të bukur, që të thuhet: ‘Filani ka zë të bukur’. E në këtë nuk ka asnjë të mirë. Dhe ka prej tyre që e mësojnë atë dhe e zbatojnë gjatë ditës dhe natës së tyre, pa u shqetësuar se kush e di dhe kush nuk e di.”⁴¹

54- قال الإمام الصادق (عليه السلام): إن من الناس من يتعلم القرآن ليقل فلان قارئ، ومنهم من يتعلمه فيطلب به الصوت فيقال فلان حسن الصوت، وليس في ذلك خير، ومنهم من يتعلمه فيقوم به في ليله ونهاره، لا يبالي من علم ذلك ومن لم يعلمه.

الكافي: 2 / 608 / 6.

⁴¹ “Kafij”, vëll. 2, f. 608, hadithi nr. 6.

Dëgjimi i Kur'anit

55 – I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush dëgjon me vëmendje një ajet nga Kur’ani, është më mirë për të se mali Thubejr prej ari.”⁴² (Thubejr është emri i një mali të madh në Jemen.)

استماع القرآن

55- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): من استمع آية من القرآن خير له من ثبير ذهب، والشير اسم جبل عظيم باليمن.

البحار: 92 / 20 / 18.

⁴² “Biharul Anuar”, vëll. 92, f. 20, hadithi nr. 18.

56- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Lexuesit të Kur’anit i largohet belaja e kësaj bote, ndërsa atij që e dëgjon Kur’anin i largohet belaja e Botës Tjetër.”⁴³

56- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): يدفع عن قارئ القرآن بلاء الدنيا، ويدفع عن مستمع القرآن بلاء الآخرة.

كنز العمال: 4031.

⁴³ “Kenzul Ummal”, hadithi 4031.

57- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kush dëgjon me vëmendje një ajet nga Libri i Allahut, i shkruhet një e mirë e shumëfishuar, dhe, kush lexon një ajet nga Libri i Allahut, ai do të jetë për të një dritë në Ditën e Kiametit.”⁴⁴

57- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): من استمع إلى آية من كتاب الله كتبت له حسنة مضاعفة، ومن تلا آية من كتاب الله كانت له نورا يوم القيامة.

كنز العمال: 2316.

⁴⁴ “Kenzul Ummal”, hadithi 2316.

Llojet e ajeteve të Kur'anit

58 – I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kur’ani ka zbritur në pesë forma: hallall, haram, muhkem (me kuptim të qartë), muteshabih (me kuptim të tërthortë) dhe shembuj. Veproni me hallallin, lëreni haramin, zbatoni muhkemin, lëreni muteshabihin dhe merrni mësim nga shembujt.”⁴⁵

أصناف آيات القرآن

58- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): إن القرآن نزل على خمسة وجوه: حلال، وحرام، ومحكم، ومتشابه، وأمثال. فاعملوا بالحلال، ودعوا الحرام، واعملوا بالمحكم، ودعوا المتشابه، واعتبروا بالأمثال. البحار: 92 / 186 / 3.

⁴⁵ “Biharul Anuar”, vëll. 92, f. 186, hadithi nr. 3.

59- I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kur’ani është zbritur mbi shtatë lloje: urdhër, ndalim, nxitje, paralajmërim, debat, tregim dhe shembull.”⁴⁶

59- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله): أنزل القرآن على سبعة أحرف: أمر، وزاجر، وترغيب، وترهيب، وجدل، وقصص، ومثل.
كنز العمال: 3096.

⁴⁶ “Kenzul Ummal”, hadithi 3096.

Ajeti më madhështor, më i drejtë, më frikësues dhe më shpresëdhënës

60 - I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Ajeti më madhështor në Kur'an është Ajeti i Kursisë. Ajeti më i drejtë në Kur'an është **“Vërtet, Allahu urdhëron për drejtësi dhe bamirësi...”** deri në fund të tij. Ajeti më frikësues në Kur'an është **“Kush bën një grimë të mirë, do ta shohë atë; dhe kush bën një grimë të keqe, do ta shohë atë”**. Ajeti më shpresëdhënës në Kur'an është **“Thuaju: O robtë e Mi që e keni tepruar kundër vetes suaj, mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut”**.”⁴⁷

⁴⁷ “Kenzul Ummal”, hadithi 2539.

أعظم آية وأعدلها وأخوفها وأرجاها

60- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

أعظم آية في القرآن آية الكرسي. وأعدل آية في القرآن * (إن الله يأمر بالعدل والإحسان) * إلى آخرها. وأخوف آية في القرآن * (فمن يعمل مثقال ذرة خيرا يره * ومن يعمل مثقال ذرة شرا يره) *. وأرجى آية في القرآن * (قل يا عبادي الذين أسرفوا على أنفسهم لا تقنطوا من رحمة الله) *.

كنز العمال: 2539.

Përmbajtja

DOBITË E STUDIMIT TË KUR'ANIT.....	5
NDIKIMET DOBIPRURËSE TË KUR'ANIT.....	11
1- Njohja e Allahut	11
2- Njohja e Profetëve (<i>Paqja qoftë mbi ta!</i>)	21
3- Njohja e Ringjalljes dhe qartësimi i çështjeve të saj	24
4- Udhëzimi nga humbja e devijimi	29
5- Lartësimi në Jetën Tjetër.....	31

6- Shërimi.....	32
7- Shpëtimi nga dënimi.....	33
KUR'ANI NË THËNIET E PROFETIT DHE TË EHLI BEJTIT <i>(Paqja qoftë mbi ta!)</i>	36
Kur'ani është fjala më e vertete.....	45
Kur'ani është shërim nga sëmundja më e madhe.....	49
Mësimi i Kur'anit	57
Shpërblimi i mësimi të Kur'anit	60
Mirësia e leximit të Kur'anit në vegjëli	65
Nxitja për të mësuar përmendësh Kur'anin	66
Shpërblimi i mbartësve të Kur'anit ..	69

Recitimi i Kur'anit.....	80
Frikërespekti në leximin e Kur'anit..	83
Leximi i Kur'anit tek prijësi i padrejtë	87
Llojet e lexuesve të Kur'anit.....	89
Dëgjimi i Kur'anit	92
Llojet e ajeteve të Kur'anit	95
Ajeti më madhështor, më i drejtë, më frikësues dhe më shpresëdhënës	97

اسم الكتاب: القرآن في اقوال النبي (ص) و اهل البيت عليهم السلام)

الاعداد: <https://ar.al-shia.org>

المترجم: الشيخ ولنت (عباس) مریا

التصحیح الأدبي: یریدا کول

التصحیح اللغوی: إسرائ مریا

الإخراج النهائي: صبریہ فزا

الغالف: صبریہ فزا

الناشر: مؤسسه قرآن، تیرانا- البانیا - 2025